



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2621 prot

Himarë, më 30.05.2022

**VENDIM**

Nr. 33, datë 27.05.2022

**PËR**

**DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQE TË ZËNË ME NDËRTIM PREJ 5.1 HA, NË  
NGASTRËN NR.51, EKONOMIA PYJORE “MALI I ÇIKËS HIMARË”, PËR INSTALIM TË  
NJË PROJEKTI FOTOVOLTAIK, SHOQËRISË “NOVA PROSPECT” sh.p.k**

Në zbatim të Nenit 54 të Ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi Civil i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr.57/2020 “Për Pyjet”, Neni 1, “Qëllimi i ligjit”, Neni 2, “Objekti dhe fusha e zbatimit”, Kreu V, neni 23, “Kategoritë e përfitimeve dhe rregullat për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar”, Neni 25, “Përfitimet nga shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar”, Vendimit nr.1064, datë 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, Miratimit Paraprak Nr.951/3, datë 13.04.2022, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Këshilli Bashkiak Himarë, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Himarë miratoi me 14 vota pro, 0 kundra, 0 abstenim dhe si më poshtë

**VENDOSI**

1. Të miratojë kërkesën për dhënie në përdorim me qera Shoqërisë “NOVA PROSPECT” sh.p.k të një sipërfaqeje të zënë me ndërtim prej 5.1 ha, në ngastrën nr.51, ekonomia pyjore “Mali i Çikës Himarë”, për instalim të një projektit fotovoltaik.
2. Të miratojë Kontratën Tip, (Bashkangjitur), që do të përdoret për dhënie në përdorim me qera.
3. Të miratojë Hartën, (bashkangjitur), që do të përdoret për dhënie në përdorim me qira të sipërfaqes sipas kordinatave shtetërore.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

